



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of
Kosovo



SEKRETARIATI - KËSHILLIT KOMBËTAR PËR ZHVILLIM EKONOMIK TË KOSOVËS

PROCESVERBAL

Mbledhja e Dytë e Sektorit Privat

Prishtinë, 14 nëntor 2019
Hotel Garden, Prishtinë



FTESË

FTESË PËR TAKIMIN E DYTË LIDHUR ME PRIORITETET E SEKTORIT PRIVAT - KKZHE - 14 NËNTOR 2019

Të nderuar anëtar dhe bashkëpunëtorë,

Së pari ju falemnderoj secilin nga Ju për kohën dhe kontributin e juaj gjatë takimeve të përbashkëta individuale.

Siç edhe ju kemi informuar, projekti ynë me mbështetje të Berzh-it, ju fton që të takohemi bashkë për të i përmbledhur të gjitha komentet lidhur me zhvillimin e sektorit privat dhe për të i definuar temat kyçe të vitit që vijon.

Kemi kënaqësinë të ju ftojmë në takimin e **dytë** me radhë me datën:

14 Nëntor 2019, në Hotel Garden nga ora 10:30- 12:30 duke vazhduar me diskutime gjatë një dreke pune.

Takimi ka për qëllim vendosjen e prioriteteve kryesore dhe qëndrimeve të unifikuara si sektor privat - bazuar në të gjitha komentet e juaja.

Pjesëmarrja si dhe kontributi i juaj si akterë kyç të sektorit privat është janë të domosdoshme për të definuar prioritetet kryesore të zhvillimit ekonomik.

Ju lutem konfirmoni pjesëmarrjen e juaj përmes emailit tek fjolla.metaj@nced-ks.com apo info@nced-ks.com

AGJENDA

14/11/2019 | 10:30-12:30

Hotel Garden

Regjistrimi

10.30 – 11.00 Regjistrimi i pjesëmarrësve

Fjala hyrëse

11.00 – 11.10 BERZH-I NË MBËSHTETJE TË SEKTORIT PRIVAT

- **Neil Taylor**, BERZH - Udhëheqës i Zyrës në Kosovë
- **Endrita Xhaferaj**, BERZH - Këshilltare e Parë për Qeverisje dhe Çështje Politike

11.10 – 11.20 MBËSHTETJA E BE-SË PËR ZHVILLIMIN E SEKTORIT PRIVAT NË KOSOVË

- **Vadim Deleu**, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë

11.20 – 11.40 RISHIKIMI I SHTYLLAVE ME PRIORITET PËR ZHVILLIMIN E SEKTORIT PRIVAT/
REFORMIMI I PUNËS SË KKZHE-SË

- **Lindita Daija**, Drejtore e Sekretariatit të Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik (KKZHE)

Prezentime dhe diskutim nga përfaqësues të sektorit privat

11:40 – 12:20 PRIORITETET PËR ZHVILLIMIN E POLITIKAVE

- 2-4 çështje me prioritet për t'i trajtuar në radhë të parë me Qeverinë e re
- Struktura dhe puna e grupeve punuese
- Legjislacioni i rëndësishëm që të shqyrtohet/konsultohet
- Formati dhe anëtarësimi në KKZHE

12:20 – 12:30 Përmbledhja e prioriteteve kyçe dhe zhvillimet e ardhshme

12:30 – 13:30 Dreka

TABELA E PJESËMARRËSVE

Neil Tylor	BERZH
Leonora Kusari	BERZH
Endrita Xhaferaj	BERZH
Lindita Daija	KKZHE
Gent Nushi	KKZHE
Dita Dobranja	KKZHE
Olivera Ceni-Bardiqi	Oda Ekonomike e Kosovës
Ardita Hajra	Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë
Alketa Blakaj	Oda Ekonomike Gjermane në Kosovë
Lumnije Ajdini	Aleanca Kosovare e Bizneseve
Emrush Ujkani	Këshilli i Investitorëve Evropian
Astrit Panxha	Klubi i Prodhuesve të Kosovës
Mirjeta Shala	Oda e Afarizmit të Kosovës
Linda Shala	Dhoma Ekonomike e Grave të Kosovës - G7
Vjollca Çavolli	Dhoma Ekonomike e Grave të Kosovës - G7
Saxhide Mustafa	Forumi Ekonomik i Grave
Arieta Vula Pozhegu	Shoqata e Përpunuesve të Drurit të Kosovës

TEMAT PËR DISKUTIM

1. INFORMALITETI DHE MASAT E PROPOZUARA PËR LUFTIMIN E INFORMALITETIT	2. RITJIA DHE PROMOVIMI I EKSPORTEVE
<ul style="list-style-type: none"> ❖ Aprovimi dhe themelimi i Gjykatës Ekonomike; ❖ Ri-aktivizimi i Bordit për shqyrtimin e ankesave; ❖ Rritja e bashkëpunimit ndërmjet ATK-së dhe Doganave përmes takimeve të rregullta; ❖ Ulja e punësimit joformal duke institucionalizuar skema stimuluese (p.sh. lirim nga taksat); ❖ Institucionalizimi i mekanizmit alternativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve; ❖ Të integrohen mekanizma alternative si ndërmejtësimi dhe arbitrimi tek zgjidhja e mosmarrëveshjeve në kontratat ndërmjet operatorëve ekonomik (bizneseve); ❖ Funkcionalizimi dhe institucionalizimi i Mekanizmit të Ankesave. 	<ul style="list-style-type: none"> ❖ Sigurimi i njohjes ndërkombëtare të dokumenteve dhe çertifikatave të produkteve të prodhuara; ❖ Integrimi i ekipeve të specializuara për sektorin e prodhimit në ATK; ❖ Ulja e kostos së energjisë elektrike për kategorinë e biznesit; ❖ Aplikimi i vazhdueshëm i stimujve fiskal (lirim nga dogana për lëndën e parë); ❖ Përforcimi i diplomacisë ekonomike dhe promovimi i eksportit të Kosovës përmes misionëve diplomatike; ❖ Mbështetja institucionale në përmisimin e kualitetit të produkteve; ❖ Krijimi i një numri unik për identifikimin e prodhuesve.

3. RITJA E QASJES NË FINANCA, KANALIZUAR DREJT PËRMIRËSIMIT TË CILËSISË	4. ARSIMI – PËRSHTATJA E KURRIKULAVE PËR T’I PËRMBUSHUR NEVOJAT E SEKTORIT PRIVAT
<ul style="list-style-type: none"> ❖ Përforsimi i partneriteteve me bankat komerciale në Kosovë; ❖ Ngritja e pikës referente për kualitet të produkteve duke vënë prag minimal të plotësimi të standardeve ndërkombtarisht të pranueshme; ❖ Rritja e investimeve në infrastrukturën e sigurimit të cilësisë; ❖ Lehtësimi i qasjes në financa përmes Fondit për Garanci Kreditore; ❖ Aktivizimi dhe sigurimi i kredive për teknologji dhe paisje për të ngritur produktivitetin përmes fondit garantues. 	<ul style="list-style-type: none"> ❖ Zhvillimi i një analize gjithëpërfshirëse të tregut të punë dhe edukimit profesional; ❖ Hartimi i Strategjisë Kombëtare për arsim dhe treg të punës; ❖ Adresimi i hendekut të aftësive dhe ndryshimi i kurikulës së sistemit të arsimit për t’u përputhur me nevojat e tregut; ❖ Inkurajimi i investimeve në hulumtim dhe zhvillim; ❖ Ndryshimi i Ligjit të Punës në përputhje me nevojat e tregut; ❖ Mbështetja e qendrave profesionale në ripërcaktimin e kurrikulave të tyre; ❖ Rritja e numrit të skemave për ushtrimin e zanatit brenda arsimit formal; ❖ Hartimi i planit kombëtar për trajnime dhe arsim afatgjatë.

SHËNIMET KYQE NGA TAKIMI I DYTË I SEKTORIT PRIVAT

Neil Taylor – Udhëheqësi i zyrës së EBRD/BERZH-it në Kosovë uroi mirëseardhje të gjithëve dhe i falemnderoi të gjithë pjesëmarrësit-përfaqësuesit e sektorit privat për pjesëmarrje në takim. Ai përgëzoi Znj. Lindita Daija, Drejtore e NCED, për përzgjedhjen dhe kompletimin e stafit profesional të zyrës së NCED/KKZHE-së në Kosovë si dhe për fillimin e punës thelbësore për sfidat në aspektin e zhvillimit ekonomik. Ai theksoi qartë rëndësinë e punës që ky ekip vazhdon të bëjë dhe shpresoj që së shpejti puna e Këshillit me të lartë në nivel të Kryeministrit të intensivkohet në mënyrë që ky Këshill të ketë mundësinë të kontribuoj që takimet e NCED/KKZHE të kenë përmbatje dhe rezultate më thelbësore drejtë zhvillimit të sektorit privat. EBRD/BERZH-i do të mbështet fuqishëm punën e Këshillit dhe do të qëndroj në gatishmëri për të përkrahur zhvillimin ekonomik të vendit tonë.

Endrita Xhaferaj, Këshilltare e Parë për Qeverisje dhe Klimë të Bërit Biznes-për rajonin e Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë - poashtu falemnderoi të gjithë pjesëmarrësit-përfaqësuesit e sektorit privat për pjesëmarrje në takim. Ajo sqaroi se BERZH-i si organizator përkrah punën e Këshillit të ngjashëm në shumë shtete ku është prezent. Për më tepër, i kanë dhënë rëndësi të veçantë pasi që BERZH-i ndihmon sektorin privat duke bërë analiza relevante që janë edhe kërkesa drejtë përmisimit të klimës të bërit biznes, analiza të cilat poashtu i ndihmojnë punës së përfaqësuesve të sektorit privat tha Znj. Xhaferaj. Ajo poashtu përgëzoi punën e Këshillit në Kosovë për organizimet e takimeve të këtij lloji ku ftohen akteret kyç të sektorit privat.

Z.Deleu - Znj. Daija, shprehu keqardhje pasi që Zt. Deleu nuk ka patur mundësi të jetë prezent në këtë takim për arsye personale shëndetësore. Sidoqoftë ai ka dërguar mesazh për përkrahjen.

Lindita Daija falemnderoj, Zt. Taylor dhe Znj. Xhaferaj për përkrahjen e tyre në punën e këtij projekti me rëndësi. Ajo theksoi që ky është takimi i dytë i këtij formati-domethënë takim konsultativ me përfaqësuesit e sektorit privat. Dhe si rezultat i takimit të parë, ku edhe janë diskutuar një numër i madh i çështjeve të cilat përfaqësuesit e sektorit privat i kanë drejtuar në nivelin më të lartë të Qeverisë, në takimin e sotëm, të dytin me radhë, janë definuar çështjet me prioritet, domethënë 4 shtylla kyçe. Këto janë paraqitur në një dokument përmbledhës-një faqe. Këto informata janë përmbledhur në bazë të hulumtimeve të stafit të NCED-KKZHE, në bazë të dokumentave të publikuara të asociacioneve të sektorit privat dhe në bazë të takimeve individuale me përfaqësuesit e sektorit privat. Domethënë prioritetet e sektorit privat janë kategorizuar në 4 shtylla:

- I. Të adresohen çështjet e informalitetit;
- II. Rritja dhe promovimi i eksporteve;
- III. Rritja e qasjes në financa kanalizuar drejt përmirësimit të cilësisë;
- IV. Të përshtaten kurrikulat e arsimit formal dhe joformal për t'i shërbyer nevojave të sektorit privat.

Daija, prezantoi ekipin e NCED/KKZHE, e cila përbëhet nga: Zt. Gent Nushi, Ekspert Ligjor, Znj. Dita Dobranja, Eksperte Ekonomike, si dhe Znj. Fjolla Metaj - Përgjegjëse për Administratë dhe Komunikim. Domethënë prezentimi i shtyllave do të bëhet bashkarisht me dy ekspertet.

Pjesë e dytë të takimit është çështja e prioritetimit të sektoreve kryesor të tregut. Znj. Daija si propozim theksoi që nga të dhënat e të gjithëve, 3 sektore kyçe që janë promovuar janë: sektori i agro-biznesit, sektori i BPO/ICT si dhe sektori i turizmit.

Poashtu, ajo vazhdoi diskutimin duke cekur që si pjesë e tretë e takimit do të jenë diskutimet lidhur me çështjet lidhur me punën e Keshillit - KKZHE/NCED:

- ❖ 2-4 çështje me prioritet për t'i adresuar fillimisht Qeveria e re
- ❖ Struktura dhe puna e grupeve punuese
- ❖ Legjislacioni i rëndësishëm për tu shqyrtuar / konsultuar
- ❖ Formatimi dhe anëtarësimi në KKZHE

Për të u fokusuar në çështjet kyçe fillon prezentimi i 4 shtyllave kryesore të prioritetëve të sektorit privat. Si shtyllë e parë është:

INFORMALITETI DHE MASAT E PROPOZUARA PËR LUFTIMIN E INFORMALITETIT

- ❖ Ri-aktivizimi i Bordit për shqyrtimin e ankesave;
- ❖ Rritja e bashkëpunimit ndërmjet ATK-së dhe Doganave përmes takimeve të rregullta;
- ❖ Ulja e punësimit joformal duke institucionalizuar skema stimuluese (p.sh. lirim nga taksat);
- ❖ Institucionalizimi
- ❖ Aprovimi dhe themelimi i Gjykatës Ekonomike; i mekanizmit alternativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;
- ❖ Të integrohen mekanizma alternative si ndërmejtësimi dhe arbitrimi tek zgjidhja e mosmarrëveshjeve në kontratat ndërmjet operatorëve ekonomik (bizneseve);
- ❖ Funksionalizimi dhe institucionalizimi i Mekanizmit të Ankesave (IFC).

Në pikën e parë: Aprovimi dhe themelimi i Gjykatës Ekonomike – u cek fakti që kjo iniciativë është përkrahur edhe nga Qeveria, dhe pas takimit të stafit të NCED/KKZHE me përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, është pranuar informata që është draftuar koncepti i cili pritet të aprovohet nga Qeveria në ardhje dhe të vazhdon implementimi për themeluar këtë institucion.

Sa i përket, Bordit për shqyrtimin e ankesave, të gjithë përfaqësuesit e asociacioneve të bizneseve janë dakorduar njëzëri që ky mekanizëm ka qenë funksional dhe i ka shërbyer vet qëllimit të tij dhe kërkohet ri-aktivizimi i këtij mekanizmi. Nga diskutimi i stafit të NCED me personat kompetent në Ministri të Financave, është sqaruar që për këtë mekanizëm janë duke u krijuar bazën ligjore për ri-aktivizimin e këtij mekanizmi dhe si i tillë është inkuadruar edhe në ndryshimet ligjore të ligjit mbi ATK-në. Info shtesë: “Një gjë e tillë është imponuar në bazë të Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat, me të cilin ligji është përmbyllur mandati i Bordit të Pavarur për Rishqyrtime dhe Ankesa më 31.12.2014. Të gjitha përgjegjësitë dhe kompetencat e këtij Bordi kanë kaluar në Gjykatën Themelore, Departamenti për çështje administrative - Divizioni fiskal.”

Znj. Daija, theksoi që në kuadër të KKZHE/NCED janë të parapara takime të rregullta bashkë-anëtarët me Dogana dhe ATK si anëtare poashtu të këtij Këshilli si ndër agjensionet kryesore që nderlidhen me klimën e të bërit biznes në Kosovë.

Duke pasur parasysh që akoma ka një shkallë të lartë të punësimit jo-formal, propozohet që ulja e punësimit joformal të bëhet duke institucionalizuar skema stimuluese (p.sh. lirim nga taksat); për një periudhë të caktuar derisa biznesi të krijoj kushtet për pagesë të plotë të pagave dhe obligimeve tatimore si dhe kontributeve pensionale. Duhet patur parasysh që masat e këtij lloji janë aplikuar nga projekte ndërkombëtare në bazë të praktikave të aplikimit të masave aktive në tregun e punës.

Dy pikat me radhë: Institucionalizimi i mekanizmit alternativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve; si dhe integrimi i mekanizmave alternativ si ndërmejtësimi dhe arbitrimi tek zgjidhja e mosmarrëveshjeve në kontratat ndërmjet operatorëve ekonomik (bizneseve).

Mekanizmi per Bordin e ankesave është inicuar përmes IFC (*detaje të prezentuara nga Zt. Ujkani -nga Konventa e New York-ut*). Ky bord do të ketë qasje gjithëpërfshirëse dhe i inkorporuar në ligjin për investime strategjike, në kuadër të zyrës së Kryeministrit. Rishqyrtimi i këtij mekanizmi është proces në vazhdimësi dhe informata do të bartet tek përfaqësuesit e sektorit privat në vazhdimësi. Ideja është që të përmiresohet qasja e investitorëve të huaj dhe të mbrohen investimet e huaja në Kosovë. Kuptohet kjo iniciative duhet të sqarohet dhe të eliminohen kontraditat për përcaktimin e plotë të funksionimit të këtij mekanizmi dhe çfarë trajte duhet të merr ky mekanizem përfundimisht.

Astrit Panxha, diskutoi ndryshim/plotësimin e titullit të kësaj shtylle – ri-emertimin e shtyllës së parë për shkak të temave të inkuadruara nën këtë kategori. U diskutua opioni i emertimit: Informaliteti dhe masat për rregullimin e konkurrencës, apo fuqizimin e konkurrencës së lirë në treg. Pasi që titulli i tanishëm është shumë i ngushtë për temat që i përfshijnë. Një opcion shtesë u diskutua edhe informaliteti dhe konkurueshmëria, nga Znj. Xhaferaj, si një term më gjithëpërfshirës për temat që parashihen të shqyrtohen nën këtë kategori. Ai kërkoi që brenda kësaj shtylle të përfshihet çështja e vonesave në pagesa- ku gjendet edhe akti i disiplinës financiare, praktikat jo të drejta tregtare dhe të fuqizohet autoriteti i konkurrencës në Kosovë; si çështje të rëndësishme për këtë shtyllë pasi që kompanitë prodhuese detyrohen të hyjnë në kontratraktuale me kushtëzime dhe qeveria është vonuesi më i madh i pagesave që e dëmton konkurrencën e lirë. Znj. Cavolli theksoi që pajtohet me titullin: “Informaliteti dhe masat e propozuara për rregullimin e konkurrencës.” Diskutim me i gjërë u zhvillua rreth kësaj teme rreth sqarimit në mes të konkurrencës dhe konkurueshmërisë.

Zt. Panxha cek faktin që ka rëndësi dëmtimi i marrëdhënieve me partner vendor konsiderohet si rrezik.

Gent Nushi, ekspert ligjor sqaroi se ligji pasi që ka hy në fuqi 7 Dhjetor 2016, dhe si obligim i MTI dhe BQK, mbi vonesa në pagesa parashikon ndëshkimin e bizneseve që nuk e respektojnë këtë ligj. BQK akoma obligohet të nxjerr një udhëzim administrativ për aplikim të këtij ligji, por edhe MTI duhet të bëjë një kampanjë më të fuqishme pasi që shumë akterë nuk janë të vetëdijshëm për egzistimin e këtij ligji.

Znj. Olivera Cena – theksoi faktin që OEK e ka Qendrën e Arbitrazhit Rajonale, që është një projekt i cili pritet të zgjerohet edhe në Kosovë.

Znj. Hajra: është me rëndësi që të mos krijohen mekanizma të ri te arbitrazhit por të promovohen këto struktura egzistuese.

Znj. Daija: Pasi që aplikimi i arbitrazhit në zgjedhjen e kontesteve shihet si praktikë e mirë është menduar që kjo praktikë të replikohet apo zgjerohet tek të gjithë përfaqësuesit e sektorit privat dhe të shikohet mundësi e institucionalizimit të kësaj praktike edhe në nivel qeveritar tek kontraktimi i shërbimeve publiko private. Është me rëndësi të cekët se sa i perket kesaj praktike duhet të replikohen edhe tek të gjithë partnerët në biznes. Apo siq u diskutua te promovohen iniciativat egzistuese që janë në kuadër të OEK apo OEAK.

=====

Zt. Gent Nushi prezantoi shtyllen e dytë - Rritja dhe promovimi i eksporteve:

- ❖ Sigurimi i njohjes ndërkombëtare të dokumenteve dhe çertifikatave të produkteve të prodhuara;
- ❖ Integrimi i ekipeve të specializuara për sektorin e prodhimit në ATK;
- ❖ Ulja e koston së energjisë elektrike për kategorinë e biznesit;

- ❖ Aplikimi i vazhdueshëm i stimujve fiskal (lirim nga dogana për lëndën e parë);
- ❖ Përforcimi i diplomacisë ekonomike dhe promovimi i eksportit të Kosovës përmes misioneve diplomatike;
- ❖ Mbështetja institucionale në përmisimin e kualitetit të produkteve;
- ❖ Krijimi i një numri unik për identifikimin e prodhuesve.

Zt.Nushi, tha se në kategorinë 2 dhe si pikë e parë është rritja dhe promovimi i eksporteve ku është paraparë, sigurimi apo lehtësimi i procedurave për marrjen e dokumentave dhe çertifikatave të produkteve të prodhuara në Kosovë. Domethënë propozohet që insitucionet përgjegjëse të iniciojnë marrëveshje bashkëpunimi apo mirëkuptimi për njohjen reciproke të çertifikatave apo dokumentave me partnerët kryesor si dhe krijimin e ekipeve monitoruese, që do të shërbejnë si pika kontakti, gjatë zbatimit të këtyre marreveshjeve bazuar në informatat e pranuar nga kompanitë eksportuese.

Pika e dytë, integrimin e ekipeve të specializuara në ATK për sektorin e prodhimit, për të krijuar bashkëpunim më të afert për t'u adresuar kërkesat kyçe në sektorit të prodhimit si p.sh. në lidhje me mos-njohjen e humbjeve në proceset e prodhimit.

Si pikë e tretë, ulja e kostos së energjisë elektrike për kategorinë e biznesit, parashihet rritja e investimeve publikeve dhe private në eficiencë, si dhe në fushën e burimeve të ripërtritshme për bizneset prodhuese/eksportuese.

Si pikë e tretë në këtë kategori, parashihet aplikimi i vazhdueshëm i stimujve fiskal (lirim nga dogana për lëndën e parë); Në këtë pikë, si shembull mund të marrim praktikat ndërkombëtare, që të vihet një kufi në bazë të sasisë që një kompani prodhon apo eksporton, p.sh. nëse një kompani prodhon/eksporton mbi 50 apo 60% atëhere jepet e drejta si biznes për një tarifë më të favorshme për energji elektrike.

[MIN 24:04]

Zt. Nushi vazhdoi prezentimin e pikës së katërt nga kolona e dytë, për aplikimin e vazhdueshëm të stimujve fiskal (lirim nga dogana për lëndën e parë). Ai mori shembullin e shtetin e Turqisë i cili me qëllim të nxitjes së eksportit, ka paraparë lirime nga tatimi në të ardhurat e korporatave që kanë eksportuar më shumë se 65% të prodhimit të tyre në tregjet e jashtme.

Znj. Daija komentoi se kjo lidhet me Bordin e Pavarur që ekziston në kuadër të Ministrisë së Financave, Dogana, ATK. Ajo tha se disa nga anëtarët kanë kërkuar që lista e lëndës së parë të zgjerohet se çka kategorizohet si lëndë e parë që shërben drejt prodhimit të një produkti final. Gjithashtu theksoi se një gjë e tillë është diskutu edhe me dy anëtarë të këtij komisioni dhe ata kanë shprehë gatishmërinë që kur kemi kërkesë konkrete rreth zgjerimit të kësaj liste të bëhemi bashkë përmes KKZHE si anëtarë dhe të kemi një nën-grup punues në kuadër të barrierave tregtare dhe t'i prezentojmë këto lëndë të para që kërkohen të shtohen, dhe të vazhdojë kjo praktikë sipas nevojës, në baza 6 mujore ose baza 3 mujore.

Zt. Panxha sugjeroi që një gjë e tillë duhet të jetë 3 mujore. Ndërsa **Znj. Daija** njoftoi se kanë biseduar me ta, ata janë dakorduar në princip.

Zt. Nushi prezntoi pikën e radhës nga tabela, përforcimi i diplomacisë ekonomike dhe promovimi i eksportit të Kosovës përmes misioneve diplomatike;

- Fuqizimi i kapaciteteve të zyrtarëve të misioneve diplomatike të Kosovës për promovimin e produkteve të Kosovës, si dhe shtimi i aktiviteteve në koordinim me Agjencinë e Kosovës për Mbështetje të Ndërmarrjeve dhe Investimeve (KIESA), odave ekonomike dhe bizneseve

individuale. Përveç promovimit të produkteve, roli i diplomacisë ekonomike do të duhej fokusuar edhe në gjetjen e partnerëve potencialë tregtarë për prodhuesit nga Kosova.

Mbështetja institucionale në përmisimin e kualitetit të produkteve;

- Mbështetja për kompanitë prodhuese gjatë viteve të ardhshme duhet të orientohet në hapa që ndihmojnë në rritjen e cilësisë së produkteve.
- Ky rekomandim ka të bëjë jo vetëm me nevojën për ndërtimin e laboratorëve testues, mirëpo edhe me ngritjen e kapaciteteve njerëzore në këtë fushë dhe anëtarësimin e organizatave nacionale në trupat evropiane dhe botëror në fushën e infrastrukturës së cilësisë.
- Krijimi i një numri unik për identifikimin e prodhuesve.

Znj. Kusari: u interesua të sqarohet nëse është fjala për përmirësim të standardeve apo të kualitetit të produkteve? Duke sqaruar se janë dy gjëra të ndryshme.

Zt. Nushi: Kualiteti.

Znj. Kusari bazuar në eksperiencat e saj potencioi se tek kualiteti konsiderohet atëherë dhe dizajni, paketimi, cilësia e produktit, nuk janë vetëm standardet, certifikimi ose analiza. Nëse i shtijmë edhe këto dyja, se problemi më i madh i prodhuesve nuk është vetëm ngritja e sistemi të cilësisë, por edhe dizajni dhe kualiteti, dhe konsistenca në kualitet.

Znj. Daija vazhdoi të sqaronte se një gjë e tillë ka filluar nga laboratorët testues që ka qenë kërkesë specifike e të gjithëve, por ne mundemi me u zgjeru në disa kategori – nëse mendoni që duhet me e zgjeru listën përtej ngritjes së cilësisë në dizajn dhe më tutje, atëherë mund ta bëjmë këtë.

Znj. Mustafa theksoi se pa u plotësuar standardet nuk mundën të eksportohen, ekstra shtesë koston për bizneset. Njëherit **Znj. Kusari** shtoi se te pikat e standardizimit është problem, jo vetëm testimi nëpër laboratore se ajo është me vërtetë a është cilësia, po problemi është edhe brenda kompanive se ata nuk kanë laboratore testuese edhe s'kanë konsistencë të kualitetit, e kjo e bën edhe më të pamundshme ngritjen e standardit, certifikimin, ose ricertifikimin. Tutje me komente për këtë temë dha **Znj. Mustafa** duke i jap rëndësi të veçantë se duhet edhe me shiku në çfarë kushte janë fabrikat ekzistuese, ato që dojnë me eksportu, se nuk është e logjikshme ato me funksionu pa laboratore. Ose pa plotësim të standardeve. Te ulja e koston së energjisë, nuk duhet ndoshta me u fokusu vetëm në kategori të bizneseve që eksportojnë.

Znj. Daija vazhdoi që sqaronte se arsyeja pse më shumë janë marrë si shembull këto pika është që ka dhe kishte praktika rajonale. Por duke e pasur parasysh ngecjen apo mos gatishmërinë për të bërë hapa në këtë drejtim nga ana e njerëzve kompetent, është pa e rrugës që të fillohet të paktën me këtë kategori të bizneseve që e ofron këtë shërbim të bëj lëshime, pastaj kjo mund të zgjerohet tutje. Ajo shtoi se duhet pasur parasysh që kjo çështje ka kohë që ngritet e nuk lëvizet, prandaj është menduar një mënyrë pak më kreative të lëvizet gjysëm hapi dhe pastaj të vazhdohet tutje.

Diskutimin e vazhduan tutje **Znj. Vula – Pozhegu** duke marr shembull rastin nga organizata që ajo udhëheq se si identifikimi i prodhuesit në eksportues dhe jo eksportues është e vështirë me që në këtë rast krejt prodhuesit i ki eksportues, në rastin e përpunimit të drurit. Ajo shtoi se duhet me pasur kritere se çfarë vlere apo çfarë eksporte, përndryshe të gjithë prodhuesit të përfshihen. Tutje me komente vazhdoi **Zt. Panxha** ku tregoi se Klubi që ai drejton ka japur rekomandim për eksportin tek Ministria e Financave më herët, duke shprejguar që tatimi në fitim në eksport, të jetë 0% për kompanitë vendore. Vetëm të hyrat që gjenerohen nga eksporti, të tatohen me 0%. Ai tha se implikimet buxhetore kanë qenë diku € 3-5 milion në vit, për të gjitha eksportet në Kosovë.

Znj. Daija i kërkoi të sqaronte se për sa vite kishte me qenë kjo shumë e qëndrueshme? Dhe **Zt. Panxha** tha se: mund ta kemi target deri sa të arrin në €1bn eksporti. Sepse rritja e eksportit nëse e shohim, është shumë e ngadalshme. Janë dy forma me i ndihmu kompanitë: atë tatim munden me e shfrytëzu me e ulë çmimin e produktit, me qenë ma konkurrent në treg; ose atë tatim që kishin me e pagu, me e riinvestu në kapacitete të reja. Kjo i tërheqë edhe kompanitë e huaja, qe me shfrytëzu edhe Kosovën si bazë prej ku me eksportu, me ardhë me investu në Kosovë.

Znj. Daija: Sa ma shumë qe kemi praktika bindëse, me ardhë me 2-3 propozime konkrete, cila është më e arritshme edhe për anën e qeverisë. Deri tash nuk ka pasë lëvizje konkrete, kështu që të vijmë me 2-3 modele, të konsiderohen implikimet financiare nga ana e qeverisë, dhe të vazhdohet tutje.

❖ *Mbështetja institucionale në përmisimin e kualitetit të produkteve;*

Zt. Ujkani vazhdoi duke komentuar pikën e parafundit nga kolona e dytë duke e saqruar si në vijim: na ndihmon të gjithëve, neni 10, në Ligjin për Tregti të Brendshme – shumë i diskutueshëm, por është dashur me ju referu versionit të fundit që ka shku. E me ndryshimin e këtij neni, i cili fillimisht ka paraparë barriera shtesë. Tash është propozu neni i ri, që besojmë që është përmirësim. Edhe ligji i parasheh, që Ministria të nxerrë udhëzime administrative në 5-10 vite, kështu që nëse e shohim që është përmirësu tregu për me vendosë standarde, e bejmë këtë me anë të udhëzimeve administrative – e mira është që të interpretohet kështu ligji. I mbetet organeve ne diskrecion, që me vendose mas 5-10 vjete a dojnë me i ndrru standardet. Nuk pashë diçka që i referohet eliminimit të barrierave administrative dhe rregullative të panevojshme që ekzistojnë, në përgjithësi.

Znj. Daija theksoi se Sekretariati si prioritet ka diskutuar numrin e licencave që shtohen, në vend se të reduktohen, kohën e procesimit, edhe rankimi në Bankë Botërore do të tregohet edhe në vitin që vjen. Ajo tregoi gatishmëri që *informaliteti* të qëndrojë si prioritet në shtyllën e parë. Ajo theksoi se është e rëndësishme që temat dhe kërkesat të identifikohen në mënyrë sa më specifike, dhe të vendosen si prioritetete, rrjedhimisht që të eliminohen duke u realizuar në vitin që vjen. Ajo citoi: të jemi më konciz – ne vazhdojmë me takime, që t'i identifikojmë veprimet specifike të cilat mundemi me i arritë.

❖ *Diskutim: Ulja e kostos së energjisë elektrike për kategorinë e biznesit;*

Zt. Panxha komentoi mbi temën e Te energjia – është diskutu shpesh, çmimi i energjisë është më i ulit në rajon, nuk është nevoja të ulet çmimi, është nevoja të rregullohet furnizimi me energji, të përmirësohet qasja në energji, dhe të ketë konsistencë në furnizim. Sepse ndalesat e rrymës shkaktojnë më shumë probleme se sa çmimi.

Znj. Daija njoftoi se në shtyllat e reja që Sekretariati i ka paraparë si prioritet dhe temën për infrastrukturë dhe klima e investimeve, ku në infrastrukturë është furnizimi adekuat me energji, që të mos ketë probleme teknike. Duke e pasur parasysh që sektori energjisë ende e ka në fuqi vendimi i ERO-s për mbrojtjen e disa kategorive të shoqërisë, dhe të mos shkohet ende në treg të liberalizuar. Znj. Daija tha se është e dukshme që të gjithë pajtohen që kjo të vazhdoj edhe më tutje.

Znj. Shala komentoi duke thënë se duhet përfshirë dhe sektori i shërbimeve posaçërisht me fokus në TIK. Znj Shala shtoi duke sugjeruar gjithashtu që të shtohen ekipe të specializuara të ATK, le të ekzistojnë edhe për sektorin e shërbimeve, një ide e tillë znj. Shala tha se ka ardhur si pasojë që kompanitë janë ankuar me që nuk kanë pasur përvoja të mira. Segmenti i shërbimeve si sektor duhet të integrohet – në të gjitha kategoritë ku është e mundshme. **Znj. Daija** vazhdoi duke thënë se Business Process Outsourcing është kategori e cila nga të gjithë anëtarët është cekur si një nga sektorët me potencial dhe me prioritet.

Znj. Çavolli morri fjalën për të cekur se tek tema mbi rritjen dhe promovimin e eksporteve, si pikë e parë duhet të jetë përmirësimi i imazhit të Kosovës meqë kjo do t'i rrisë eksportet. Ndëra tek pika e diplomacisë ekonomike, ajo tha se na duhen atache ekonomik në ambasada – me të cilët do të kishte komunikim të

drejtperdrejt mes tyre dhe bizneseve si dhe takime të rregullta. Sugjerim plotësues pati nga **Znj. Vula-Pozhegu** e cila tha se për promovimin e eksporteve dhe investimeve duhet të ketë një Agjensi e cila funksionon si e pavarur.

Znj. Vula-Pozhegu tek esporti komentoi duke thënë se duhet të konsiderohet edhe ri-eksporti meqë sipas saj ka kompani që investojnë në Kosovë, por nuk e prodhojnë krejt “value-chain” në Kosovë. Replikë pati nga **Znj. Shala** duke thënë se atop rap konsiderohen si eksporte. Ndërsa **Znj. Kusari** e plotësoi duke thënë se nuk po specifikohet vendi i origjinës.

Znj. Daij edhe një herë potencoi se detyrë e Sekretariatit është identifikimi dhe definimi i prioritetëve dhe mbetet detyrë e Qeverisë që të vendosë se çfarë qasje merr.

❖ *Diskutim rreth atacheve ekonomik dhe nevojës për KIESA-n e pavarur**

Znj. Daija: Të gjithë po pajtohemi që KIESA duhet të, fuqizohet është fjalë diplomatike, sepse ka shumë punë për tu bërë. Dmth duhet të bëhet reformimi i KIESA-s, që ta kryej punën e vet siç duhet.

Znj. Ceni-Bardiqi tregon një rast të dështimit të KIESA-s dhe vazhdon: Nuk mund të rriten eksportet as të promovohen prodhimet vendore pa u rregullu barrierat administrative që i kemi në Kosovë. Kompanitë e frutave dhe perimeve duhet të presin 3 ditë për të marrë certifikatë për eksport, për produkte që prishen brenda një dite. Ligji për Tregtinë të Jashtme është në kundërshti me Ligjin për Masa Mbrojtëse, duhet të sigurohemi që edhe ligjet janë të harmonizuara dhe të mos bien ndesh me njëri tjetrin. Sugjerimi nga **Znj. Daija** ishte që të organizohet një takim teknik ku edhe do të identifikoheshin cilat janë problemet specifike dhe në këtë rast për barriera, të identifikohen cilat janë ato që kanë më së shumti prioritet. Njëherit **Znj. Kusari** shton që të organizohen nën-grupe punuese.

Znj. Daija vazhdoi sqarimet mbi punën e tyre dhe qasjen duke thënë: KKZHE ka punuar me vite të tëra duke i definuar problemet në nivel gjeneral, dhe duke mos i identifikuar zgjidhjet specifike. Për këtë arsye ne kemi identifikuar shtyllat me prioritet dhe prioritet brenda shtyllave, që me ditë kur të kryhen, hiqen nga rendi i ditës dhe vazhdojmë tutje. Një nën-grup punues do të formohet për ridefinim të lëndës së parë. Një nën-grup punues do të formohet për barrierat administrative, t'i definojmë rreth 10 barriera me prioritet.

Mbi temën e barrierave **Zt. Ujkani** tha të shikohen si nga aspekti i kohës që marrin për t'i marrë dokumentet, po ashtu edhe nga aspekti i asaj sa i kushton bizneseve për të marrë këto dokumente. Dokumentet që janë të doemosdoshme por marrin kohë, të konsiderohet të përmirësohet efienca e lëshimit të tyre. Ndërsa dokumentet e panevojshme të hiqen. Gjithashtu **Zt. Ujkani** komplimentoi punën e Sekretariatit të KKZHE, duke thënë se formati i diskutimit të mbajtur ishte ndryshe dhe shumë i qëlluar.

Znj. Vula-Pozhegu duke u drejtuar tek KIESA, tha se përveç fuqizimit, duhet edhe që plani 10 vjeçar, apo strategjia e këtij agjensioni të risihkohet çdo vit. Ndërsa **Zt. Panxha** shtoi se duhet që me ndryshim të ligjit t'i ndryshohet dhe mandati i KIESA-s, duke sugjeruar që të konsiderohen modalitetet të bëhet Partneritet Publiko-Privat, duke e bazuar shembullin në shumë vende që e kanë të rregulluar në atë mënyrë.

Znj. Daija sqaroi që shtylla e klimës së investimeve, të kthehet te Agjencia që duhet të veprojë si e tillë, dhe të jetë i pavarur. Të funksionojë si Agjenci e pavarur, e jo si departament brenda ministrisë.

[MIN 0:58]

Znj. Daija vazhdoi udhëheqjen e diskutimit duke theksuar dhe dy shtylla për diskutim:

1. Rritja e qasjes në financa me fokus drejtë përmirësimit të cilësisë,
2. Arsimi - përshtatja e kurrikulava për të përmbushur nevojat e sektorit privat.

Tek rritja e qasjes në financa është bërë shumë punë nga shumë donator, por le të themi se ndoshta ka nevojë të investohet më shumë në edukimin si të qasemi (disa kategori) edhe të rishqyrtohen modelet apo të rritet qasja në financa për disa kategori që janë lënë anash. Znj. Daija tha se në bazë të informatave që kishin marr nga Banka Botërore është që në Fondin Kosovar për Garantimin e Kredive do të inkuadrohet portfolio për qasje në financa për ndërmarrjet që janë start up dhe për ndërmarrjet në pronësi të grave, e cila është një gjë e mire pasi që gjithmonë ekziston problemi se si vetëdijsohet pala e fundit që e merrë këtë informat është përmes Bankave Komerciale. Tutje theksojë se një analist kredie duhet të vendos se a do e lëshojë kredinë si Bankë apo nga Fondi për Garantimin e Kredive. Lidhur me iniciativat që do merren në këtë drejtim, Banka Botërore thekson që do organizohet një fushatë informuese për të rritur efikasitetin e saj. Poashtu, Znj. Daija njoftoi të pranishmit se tash e tutje KKZHE tani më e kemi edhe web faqen e cila është e pavarur dhe do të ofroj mundësinë që kjo fushatë të bëhet poashtu edhe në web faqen e KKZHE-së, në mënyrë që aplikuesit të informohen më shumë dhe se ka këto dy mundësi për kredimarrje, sepse vërehet që punonjësit e bankave nuk japin informata dhe nuk prezantojnë mundësinë e kreditimit përmes Fondit, për arsye që mund të jenë të ndryshme si bonusi apo përfitim tjetër. Mbi këtë temë **Znj. Vula Pozhegu** shtoi sepo të funksiononte KIESA si duhej, atëherë do ekzistonte edhe portali apo gazeta informuese, ku të gjithë bizneset do kishin një adresë përmes së cilës do informoheshin për të gjitha risitë qoftë për shërbimet bankare, ligjet për çdo gjë. Bazuar në këtë parim tha **Znj. Daija** që dhe Sekretariati ka ndërmarr një hap të tillë duke ditur që ka zbrazëtirë, atëherë si KKZHE kanë ofruar këtë mundësi të qasjes tonë përmes në web faqes së Këshillit, që deri sa KIESA të përmbledhë veten dhe të funksionojë si duhet dhe në këtë mënyrë të kontribuojnë aq sa u lejon mundësia ligjore. Për sa i përket informimit, në momentin që do të ketë informatë do të iu përcjellim ju përmes takimeve tona individuale, grupe apo nëngrupe, me qëllim që si ne dhe ju të përmbushim këtë zbrazëti deri sa të ristrukturohet KIESA. Poashtu, Znj. Daija tha se e kanë paraparë edhe përforcimin e partneritet me bankat komerciale përmes shoqatës së bankave komerciale.

Znj. Daija vazhdoi sqarime dhe mbi kualitetin e produkteve, duke thënë se duhet vënë prag minimal të plotësimit të standardeve ndërkombëtarisht të pranueshme, siç ishte rasti që **Znj. Vula-Pozhegu** ka informuar Sekretariatit në takim individual për çertifikimit e produkteve të drurit me FSC lidhur me pyjet si dhe nga takimet tjera individuale, kishte dal në pah që shumë biznese kanë barriera në qasje sepse nuk përmbushin kërkesat apo kriteret ndërkombëtare. Sipas Znj. Daija formula më e mire është të mirren 10 fusha dhe ato të jenë model për fushat e tjera që do vijnë, krijon një ide për qeverinë se si të zgjedhë të gjitha fushat.

Znj. Daija komentoni dhe mbi lehtësimin e qasjes në financa përmes Fondit Kosovar për Garanci Kreditorë, e cila nënkupton qasjen në Fond përmes Bankave Komerciale e cila duhet të rimodelohet ose përmirësohet. Aktivizimi dhe sigurimi i kredive për teknologji dhe pajisje për të ngritur produktivitetin përmes fondit garantues. Lidhur me këtë Znj. Daija theksoi se duhet të ju mundësohet kompanive qasja më e lehtë për qëllim të sigurimit të paisjeve teknologjike për rritjen e aktivitetit apo kapacitetit prodhues.

Znj. Shala në bazë të përvojë dha një propozim lidhur me pikën e lehtësimit të qasjes në financa përmes Fondit Kosovar për Garanci Kreditorë. Sipas saj dihet se kemi problem me arsimimin e kuadrove në vend. Ajo propozoi që në kuadër të FKGK-së të hapet një dritare e re që garanton mundësinë e financimit apo pagimin e shkollimit të studentëve të rinj në formë të kredisë dhe rikthimin e mjeteve nga ana e tyre në mënyrë graduale pasi të punësohen.

Duke dhënë shemburll plotësues **Znj. Mustafa** komentoni se : Qasja në financa duhet rishikuar, si psh. Teb Bank ka pasur fondin për bujqësi i cili nuk është duke funksionuar dhe nuk ekziston më vullneti brenda bankes për të. Sipas informatave që kam nga FKGK ka ekzistuar marrëveshja që secila bankë të ketë një departament të veçant për këtë linjë. Secili aplikues për kredi sot kur shkon në Bankë, nuk i promovohet ky fond fare edhe pse për bankën nënkupton përfitim.

Poashtu, së dyti bankat nuk parashohin kredi për start up ose mund të marresh një kredi të tillë vetëm përmes njoftësive të brendshme, nëse nuk ke qarkullim, problem ky që po ballafaqohen bizneset. Në të ardhmen të analizohet mundësia që qeveria duhet të krijojë politika që përmes fondit drejt garantimit apo subvencionimit të interest bankar, me qëllim që kur bizneset të ekspozohen në tregjet më të mëdha të kenë performance më të mire të qeverisjes dhe atë financiare.

Më tutje Znj. Mustafa theksoi se duhet të analizohen grantet e përfituara, performanca e kompanive përfituese, stimujt që mund të ndikojnë në përmirësimin e cilësisë.

Znj. Daija morri përsëri fjalën duke thënë se: nga sa u tha nga Znj. Mustafa dolën dy pika të reja: *subvencionimi i interest bankar dhe analiza e performances së granteve mbështetëse*. Nëse nuk ka komente atëherë vazhdojmë me shtyllen e fundit, për të cilën ia kaloj fjalën ekspertes ekonomike Dita Dobranja.

Znj. Dobranja theksojë se ne të gjithë pajtohemi se shtylla që do prezantojë ka një rëndësi shumë të madhe, duke ditur se me të ballafaqohen të gjitha bizneset që ju përfaqësoni. Si shtyllë të fundit kemi marrë arsimin, me qëllim të zvogëlimit të hendekut ndërmjet asaj çka ofron tregu i punës dhe atë çka kërkojnë bizneset.

Si pikë e parë është zhvillimi i një analize gjithëpërfshirëse të tregut të punës dhe edukimit profesional e cila do të bëhet nga organet përkatëse, të parasheh jo vetëm nevojat e tashme të tregut të punës, por t'i sheh edhe trendet e të ardhmes, dhe të japë rekomandime të bashkërendimit të politikave stimuluuese të arsimit dhe nevojave të tregut të punës. Një analizë e shtetit se kah do shkojmë, cilët sektorë duam t'iu japim përparësi, fokusimi i rinisë në fusha të caktuara.

Pika e dytë është zhvillimi i strategjisë kombëtare për arsim dhe tregun e punës ku, bazuar në të gjeturat e analizës, të zhvillohet strategji afatmesme dhe afatgjatë e udhëzimit të asaj se ku dëshiron shteti i Kosovës të shkojë tutje – do të thotë cilët sektorë i konsiderojmë me rëndësi, të investohet dhe të stimulohen popullsia të aftësohen në këto sektorë.

Pika e tretë është adresimi i hendekut të aftësive dhe ndryshimi i kurikulës së sistemit të arsimit në përputhje me nevojat e tregut si veprim afatshkurtër, të merren parasysh të dhënat e sektorit privat dhe analizave tjera, dhe të investohet në zhdukjen e hendekut në mes të nevojave imediate të sektorit privat dhe ofertës së tregut të punës.

Pika e katërt është Inkurajimi i investimeve në hulumtim dhe zhvillim që nënkupton aplikimin e lehtësimeve në tatimin në të ardhurat e korporatave për shpenzimet në hulumtim dhe zhvillim, do të lehtësonin faturën tatimore të bizneseve. Pavarësisht ndikimeve me efekt afatshkurtër në të hyrat buxhetore, ngjashëm si edhe me aplikimin e masave të reja fiskale përgjatë viteve të shkuara, boshllëqet e krijuara do të mbulohen shpejtë për shkak të shtimit të aktivitetit ekonomik tek bizneset prodhuese, e rrjedhimisht edhe të rritjes së bazës tatimore.

Pika e pestë është Ndryshimi i Ligjit të Punës në përputhje me nevojat e tregut. Ligji i Punës duhet të reflektojë nevojat e tregut të punës, të parasheh tregun e punës që do të ketë ndryshime si psh ligji të parasheh punën online, punën me gjysmë orari, t'i adresojë edhe mangësitë e tregut të punës, posaçërisht duke i pasur parasysh papunesinë e lartë tek gratë dhe të rinjtë.

Pika e pesë dhe e gjashtë është Mbështetja e qendrave profesionale në ripërcaktimin e kurrikulave të tyre dhe Rritja e numrit të skemave për ushtrimin e zanatit brenda arsimit formal ku rrjedhimisht duhet të përmirësohet bashkëpunimi me sektorin privat

Pika e shtatë është Hartimi i planit kombëtar për trajnime dhe arsimimin afatgjatë ku theks të veçantë duhet t'i jepet arsimit dual, ku nga Qeveria dhe Parlamenti i Republikës të Kosovës kërkohet të miratojnë

një pako ligjore që mundëson zbatimin e sistemit të “Arsimit Dual”, sipas modelit të vendeve gjermano-folëse i cili duhet domosdoshmërisht të përshtatet me specifikat vendore.

Znj. Blakaj nga Oda Ekonomike Gjermane theksoi se disa nga kompanitë anëtare të Odes kanë hap qendrat e tyre për trajnime profesionale, mirëpo Oda ka futur në planin vjetor për vitin e ardhshëm që arsimit profesional të shtyhet përpara edhe përmes mekanizmave tjerë siç është KKZHE-ja, por edhe përmes lobimit që ne bëjmë tek institucionet tona. Ajo tha se nevojitet një proces i reformimit të arsimit, e posaqërisht arsimit profesional në Kosovë, duke u bazuar në praktikën e shteteve të rajonit, si psh. Serbia ka miratuar Ligjin për Arsim Profesional dhe prej atëherë ka pas një rritje të madhe të numrit të punësuarve, si rrjedhojë një praktikë e tillë do mund të aplikohet edhe tek ne. Më tutje ceku se ky sistem i arsimit profesional është bazuar në sistemin gjerman edhe është implementuar pjesërisht, vetëm sa i përket sistemit dual të arsimit në Gjermani. Poashtu, shtoi se Oda Gjermane është në proces e sipër të krijimit të konceptit dhe në momentin kur të përfundohet atëherë do e ndajmë me ju. **Znj. Daija** theksoi konkludimin se modeli që Oda Gjermane prezantoi të përdoret si model i qeverisë për rregullimin e kësaj fushe.

[MIN 1:20:]

Fjalën mori **Znj. Vula – Pozhegu** e cila nuk ishte e pajtimit që ekziston nevoja për analizë gjithëpërfshirëse për tregun e punës dhe edukimin profesional, meqë sipas saj ka analizë të mjaftueshme nga shoqata mbi hendekun në mes profesioneve dhe tregut të punës. E panevojshme është edhe hartimi i strategjisë sipas Znj. Vula Pozhegu. Për përmisimin e hendekut ajo propozoi që të futet praktika e nxënësve tek kompanitë, apo thënë shkurt sistemin dual të shkollimit. Znj. Vula-Pozhegu tha se gjithëmonë duhet me qenë një platformë që të gjitha këto të rregullohen përmes dy ministrive që janë përgjegjëse, Ministria e Arsimit si dhe Ministria e Punës. Kështuqë koordinimi midis këtyre dy ministrive e mundëson që të kemi shkollën profesionale të forta dhe tërheqëse për të rinjtë. Znj. Vula Pozhegu mbylli fjalimin duke sygjyeruar që prioritet e kurikulave të merren nga GIZ-i apo EYE sepse të dyja janë projekte që fokusohen në këtë pikë dhe të gjitha i kanë të definuara sipas saj, se ku duhet të intervenohet dhe çka duhet bërë.

Tek grumbullimi dhe harmonizimi i analizave/ të dhënave **Znj. Daija** theksoi se synimi është që të kenë për qëllim të arritura të matshme 1 vjeçare. Pra në bazë të imputeve nga anëtarët e sektorit privat besoj që mund të vijmë me një listë me propozime dhe po te njejtë të shtojnë komentet nëse pajtohen apo jo në bazë të kërkesave të anëtarëve të tyre.

Duke ju referuar pikës së katërt **Zt. Ujkani** tha se nëse e mendohet pak më gjatë do të duhej të ishte e para meqë është gjëja më sfiduese e vendit tonë në përgjithësi. Përkundër faktit që organizata që ai përfaqëson, kryesisht investitorët e huaj që janë prezent në Kosovë, që ndoshta më së paku ndërlihet me këtë si politikë, Zt. Ujkani mendon që Odat dhe asociacionet biznesore, dhe Sekretariati mund të shërbej si platformë, e kanë për obligim ndaj kësaj shoqërie që kur flasim për një fushë sikur kjo të propozojnë një pakt i cili do të nënshkruhet nga të gjitha partitë politike në vend. Gjithashtu e cila ka një kohëzgjatje minimale prej 10 vite nëse këtë nuk e kemi në këtë pikë ne do të çalojmë gjithëmonë, tha Zt. Ujkani.

Znj. Daija i jep fjalën Lumnije Ajdinit nga Aleanca Kosovovare e Bizneseve.

Znj. Ajdini ju referua pikës së katërt duke u pajtuar me propozimin e Znj. Vula-Pozhegu dhe sipas saj sa i përket sistemit dual të edukimit Këshilli Ekonomik Social ka ndërmarr hapa mirëpo si proces ka ngecur me rënien e qeverisë. **Znj. Daija** u sqarua duke thënë se: ne në asnjë mënyrë nuk duam duplikim të punëve, kështuqë edhe në këtë vij do të tregojmë kujdes.

Sa i përket Edukimit Profesional dhe për Tregun e Punës **Znj. Ajdini** tha se “ne i bëjmë nga dy herë analizat si AKB me UNDP, prandaj propozoj që ju si sekretariat t’i harmonizoni këto” se si replikë mbi këtë pati për të sqaruar Znj. Xhaferaj duke thënë se “: Ideja është që të japim rekomandime për KKZHE-në nuk po i hahet puna që e bënë Këshilli mirëpo të përpunohen ato që duhet të dalin si propozime finale”.

Znj. Ajdini vazhdoi tutje duke potencuar se për organizatën të cilën ajo përfaqëson është me rëndësi dhe riaktivizimin e Bordit të Pavarur për Shqyrtimin e Ankesave. Njëherit **Znj. Shala** shtoi se :ne duhet vetëm të drejtohem me kërkesën për Bordin i cili ka ekzistuar dhe është detyrë e tyra se si e zgjedhin atë.

Znj. Hajra nga Oda Amerikane potencoi se Strategjina Kombëtare për Arsim sipas saj ndërlihet me punën që veq është paraqitur në në PSAK, Planin Strategjik 2017-2021 dhe është një nga objektivat strategjia, harmonizimi i nevojave të tregut me kurikulat dhe propozon që të plotësohen ato pika që vetëm janë ekzistuese në këtë plan.

Diskutimi vazhdon si ne vijim:

Znj. Dobranja: ai plan do të skadoj me fillim te 2021 kështuqë duhet te jemi gati për nje plan tjetër pasues.

Znj. Kusari: ai plan ka skaduar akoma pa fillu.

Znj. Hajra: shumica e strategjive që i ka zhvilluar MASHT-i thujse janë shtyllat e njejta.

Znj. Daija: Më tutje mund ta shohim që të kemi një grup punues vetëm për këtë fushë dhe të vini me një propozim të gjithë ju që jeni të interesuar dhe përfshirë në këtë temë, për të përpiluar një propozim sa më konkret dhe të ngusht.

Znj. Hajra: edhe diqka, një nga propozimet e AmCham ka qenë edhe krijimi i një strategjie kombëtare për zhvillim ekonomik, mendoj që do të ishte mirë që kjo të jetë një ombrellë, që do të kishte shërbyer për qeverinë si udhëzim për të marr vendime strategjike dhe jo emocionale ashtu qysh ka ndodhur viteve të fundit.

Znj. Daija: kjo është edhe arsyeja pse kemi filluar me këtë tabelë. Sa i përket pjesës së strategjisë për arsim do të kisha propozuar që ju që jeni të interesuar, të caktojme një takim ku do rifejnojme këtë shtyllë më saktësisht, t’i vendosim 2-3 prioriete kyqe në këtë drejtim për t’i propozuar qeverisë që do të vij në pushtet.

Para përmbylljes së takimit **Znj. Mirjeta Shala** përmendi ndryshimin e ligjit të punës bazuar në nevojat e tregut, duke propozuar të ndryshohet meqë drafti final i tij përveq pjesës së tregut i dëmton shumë edhe bizneset meqë në këtë draft po favorizohen dukshëm të drejtat e punëtorëve, jo në shkallë të barabart me të drejtat e biznesit. Megjithëse dhe unë jam e punësuar mendoj se është e rëndësishme që ky ligj t’i trajtoj në mënyrë të barabart të gjitha palët.

Znj. Daija para fjalës përmblylëse sqaroi dhe një herë qëllimin takimi ka qenë e takimit që ishte dakordimi me anëtarët e sektorit privat për të qenë të unifikuar në qëndrimin dhe kërkesat të cilat do t’i parashtrihen qeverisë. Znj. Dakimi i rradhës do të jetë në aspektin e definimeve të të gjitha kërkesave të përpunuara në bazë të komenteve që janë marr gjatë komunikimit të Sekretariatit me anëtarët dhe ato që do të pasojnë në vijim. E vetmja pikë e cila nuk u diskutua për shkak të kohës ishte riformimi i punës se KKZHE-së, temë e cila mbeti që ta trajtohet në takimet e rradhës.

Znj. Shala propozoi që takimet e rradhës që përfaqësuesit e odave dhe organizatave të e prioritizojnë rëndësinë që të jenë të njejtit persona në këto takime meqë shpesh po diskutohen temat e njejta si pasojë e mos informatave të plota nga takimet paraprake, gjë që po e ngadalëson procesin e zhvillimeve.

Znj. Daija tha se një gjë e tillë tash e tutje kjo do të jetë e menaxhuar më lehtë për anëtarët meqë Sekretariati do të dërgojmë përmbledhje të diskutimit nga secili takim dhe dokumentet plotësuese, ku

secili përfaqësues do të mund të përgaditet dhe për takimet e rradhës në bazë të asaj se çka është diskutuar dhe çka mund të sjellë të re në tryezën për diskutim. Znj. Daija tha se pajtohet me Znj. Shala, sepse edhe në takimet paraprake ka ndodhur e njejtat gje në disa pika, prandaj dhe Sekretariati ka ardhur në përfundim që të gjejë një metodë për të eliminuar një dukuri të tillë. Megjithatë, do të ishte mirë që secili përfaqësues të njoftoj kolegun për takimet paraprake.

Znj. Daija falenderoj të gjithëve për kohën dhe bashkëpunimin, dhe i ftoi të pranishmit të bashkangjiten në drekë ku edhe do të mund të vazhdoj diskutimi për ato që nuk patën mundësi të diskutohen më gjërë mbrenda kohës së ndar për diskutim.